



Prishtinë, 16 korrik 2015  
Kodi i ZRRE-së: V\_742\_2015

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

##### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13/1 dhe 14 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
- Nenin 4 paragrafi 9, 10 dhe 11 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin/Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Gjurgjevik, ZK Malisheva, me kapacitet të instaluar prej 267 kW, në Komunën e Klinës, të datës 24.02.2015 të shoqërisë "LED LIGHT TECHNOLOGY KOSOVA" Sh.p.k., me adresë: „Ulpiana“ C 2, Hurja III, nr.6, 10000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, dhe
- Aplikacionin për Pranin në Skemën Mbështetëse;

në seancën e mbajtur me datë 16 korrik 2015 nxori këtë:

## V E N D I M

### Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se shoqëria "LED LIGHT TECHNOLOGY KOSOVA" Sh.p.k., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Gjurgjevik, ZK Malisheva, me kapacitet të instaluar prej 267 kW, në Komunën e Klinës, Republika e Kosovës.
- II. Aplikuesit "LED LIGHT TECHNOLOGY KOSOVA" Sh.p.k., do t'i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV. Aplikacioni i shoqërisë "LED LIGHT TECHNOLOGY KOSOVA" Sh.p.k., konsiderohet si aplikacion "në pritje" për pranin në skemën mbështetëse, dhe procesi i pranin në skemën mbështetëse do



vazhdoi pasi të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës, dhe njoftimit me shkrim nga ZRRE .

- V. Ky Vendim lëshohet për periudhë një (1) vjeçare, brenda së cilës periudhë aplikuesi obligohet që ti plotësoi kërkesat sipas pikës II të dispozitivit të këtij Vendimi, dhe me shkrim të kërkoj lëshimin e Autorizimit për ndërtim të stabilimenteve të reja gjeneruese.
- VI. Afati i përcaktuar sipas dispozitivit nën pikën VI. të këtij vendimi, me kërkesën e arsyetuar bindshëm nga aplikuesi mund të shtyhet edhe për një afat gjashtë (6) mujor, për shëndrrimin e Vendimit mbi Njoftimit për Autorizimin Preliminar në Autorizim final, dhe në rast se pala nuk parashtron kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë, Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.
- VII. Afati i përcaktuar në **pikën V. të këtij Vendimi** do të fillojnë të rrjedh nga data e njoftimit me shkrim nga ZRRE për përfshirje në skemën mbështetëse, dhe jo nga data e lëshimit të këtij Vendimi.

### **Arsyetim**

- o ZRRE me datë 24.02.2015 nga shoqëria “**LED LIGHT TECHNOLOGY KOSOVA**” Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapacitetit të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Gjurgjevik, ZK Malisheva, me kapacitet të instaluar prej 267 kW, në Komunën e Klinës, Republika e Kosovës.
- o ZRRE me datë 26.02.2015 nga shoqëria “**LED LIGHT TECHNOLOGY KOSOVA**” Sh.p.k., ka pranuar aplikacioni për pranim në skemën mbështetëse.
- o ZRRE, me datë 27.01.2015 i ka lëshuar njoftimit shoqërisë “**LED LIGHT TECHNOLOGY KOSOVA**” Sh.p.k. me të cilin i ka bërë me dije se, ZRRE deri tani ka pranuar/evidentuar disa aplikacione për ndërtimin e gjeneratorëve me paneleve solare kapaciteti i të cilave ka PËRMBUSHUR caqet për shfrytëzimin dhe mbështetjen e prodhimit të energjisë nga BRE-të, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Po ashtu ka njoftuar se me Rregullën për Pranim në Skemën Mbështetëse tarifa nxitëse “feed in” do ju garantohet vetëm aplikuesëve që kanë marr Autorizim Preliminar apo final dhe të cilët janë brenda caqeve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013.
- o Gjithashtu ka njoftuar aplikuesin se nëse dëshiron të vazhdoj me procedurat për marrjen e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, apo Autorizimin Final, në Vendim përkatës do të specifikohet se aplikacioni i tyre është “në pritje” dhe nuk do të përfshihet në skemën mbështetëse derisa të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013.
- o ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmive relevante të bashkangjitura aplikacionit, dëshmive tjera plotësuese të kërkuara nga ZRRE, dhe vlerësimit të përmbajtjes së aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





VIII. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


IX. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Merita Kostari, anëtare

  
Krenar Bujupi, anëtar